

**MJAFT!**  
www.mjajt.org


## QEVERISJA E HAPUR E PUSHTETIT GJYQËSOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

PROPOZIME PËR PËRMISIMIN E SITUATËS



Norwegian Embassy

**PARTNERËT SHQIPËRI**  
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM



## QEVERISJA E HAPUR E PUSHTETIT GJYQËSOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË PROPOZIME PËR PËRMIRËSIMIN E SITUATËS

Ky grant është mundësuar nga 'Programi i shoqërisë civile për Shqipërinë dhe Kosovën', financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA). Përmbajtja dhe rekomandimet e paraqitura nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA).

Gusht 2022

### AUTORË


Aldo MERKOÇI – Drejtor Ekzekutiv, Lëvizja MJAFT!  
Xheni LAME – Menaxhere Programi, Lëvizja MJAFT!





## Tabela e përmbajtjes:

<b>1</b>	Hyrje	4
<b>2</b>	Hapja institucionale e Pushtetit Gjyqësor në Shqipëri	6
<b>2.1</b>	Hapja institucionale e gjykatave në Republikën e Shqipërisë	6
<b>2.1</b>	Hapja institucionale e prokurorive në Republikën e Shqipërisë	9
<b>3</b>	Metodologjia e kërkimit	10
<b>4</b>	Rekomandime për hapa konkretë veprimi	11




Bazuar në metodologjinë për matjen e hapjes institucionale, Lëvizja MJAFT! ka përgatitur këtë punim mbi politikën, në të cilin janë analizuar nivelet e transparencës dhe llogaridhënies së pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë. Punimi paraqet rezultate të një kërkimi gjithëpërfshirës, bazuar në metodologji shkencore, e krijuar nga anëtarë të rrjetit të ActionSEE<sup>1</sup>. Qëllimi i këtij kërkimi është të prezantojë një këndvështrim të përgjithshëm të gjendjes aktuale të pushtetit gjyqësor, si dhe të kontribuojë në zbatimin e reformave të ndërmarra për administratën publike, të ndikojë në përforcimin e parimeve të mirëqeverisjes dhe të ndihmojë institucionet në zbatimin më eficient të detyrave të tyre operative. Ky dokument përmban rezultatet e hulumtimit të realizuar përgjatë periudhës mars – gusht 2022, si dhe rekomandime për përmirësimin e hapjes institucionale të pushtetit gjyqësor. Duke marrë në konsideratë punën e bërë ndër vite, në partneritet me organizatat e rajonit, disa prej treguesve që masin performancën janë rishikuar dhe ndryshuar në varësi të rezultateve të matura, të cilat prezantonin gjendjen e institucioneve të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë edhe mangësitë që institucionet shfaqin, dhe praktikën e mira në këtë fushë.

Në këtë studim, metodologjia e matjes së performancës së institucioneve publike është përmirësuar dhe modifikuar; treguesit e saj janë përshtatur mbi bazën e rezultateve dhe gjetjeve të monitorimit, zhvilluar vitet e shkuara, duke synuar gjenerimin e informacionit që do të kontribuojë në rezultate më të mira të projektit. Qëllimi i përdorimit të treguesve të rinj dhe të përmirësuar është shtimi i një dimensionit të ri në këtë kërkim dhe një qasje më efiçente

# REPORT

ndaj përmirësimit të hapjes institucionale në vend. Duke zotëruar njohuri, rezultate konkrete dhe analiza të qeverisjes së hapur institucionale, si dhe duke besuar në përmirësimin e punës së pushtetit gjyqësor në këtë fushë, të ndikuar edhe nga hapa konkretë të prezantuar në udhëzuesit e përgatitur, synojmë të advokojmë për një nivel më të lartë të qeverisë së hapur në Shqipëri. Për këtë arsye, kërkimit të këtij viti i janë shtuar tregues, të cilët advokojnë për standarde më të larta të transparencës proaktive.

Politika e qeverisjes së hapur duhet të jetë një politikë e zbatuar nga pushteti gjyqësor dhe duhet të përkufizohet ashtu si politikat e tjera të rëndësishme, dhe jo të vijë si rezultat i një vendimi aktual apo i gjendjes së forcës aktuale në pushtet. Propozimi ynë i adresohet vendimmarrësve të pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë. Ky punim mund të jetë i dobishëm për përfaqësuesit e institucioneve ndërkombëtare dhe për kolegët e organizatave të shoqërisë civile, të cilët punojnë mbi çështje të tilla. Në mënyrë që të arrihet një dialog publik i cilësive të larta lidhur me këto çështje, si dhe për të siguruar arritjen e parimeve të transparencës së kërkimit, institucionet publike do të informohen mbi të gjitha detajet e kryerjes së tij dhe konkluzionet e përshtatura. Databaza me të dhënat e hapura të mbledhura në kuadër të këtij programi do të jetë e aksesueshme për të gjithë të interesuarit<sup>2</sup>. Jemi në dispozicionin tuaj për të gjitha sugjerimet, kritikën konstruktive dhe diskutimet lidhur me këtë punim!



.....

<sup>1</sup> ActionSEE "Accountability, Technology and Institutional Openness in South Eastern Europe" (<https://actionsee.org/>) është rrjet rajonal organizatash nga vendet e Ballkanit Perëndimor, që kanë ndërtuar Indeksin Rajonal të Hapjes. Për të gjeneruar Indeksin Kombëtar të Hapjes për Shqipërinë është ndjekur e njëjta metodologji, sikurs Lëvizja MJAFT! është pjesë e këtij rrjeti, që prej vitit 2016.

<sup>2</sup> ActionALBANIA "Accountability, Technology and Institutional Openness in Albania": <https://actionalbania.org/en>

# 2

## HAPJA INSTITUCIONALE E PUSHTETIT GJYQËSOR NË SHQIPËRI

Sistemi gjyqësor në Republikën e Shqipërisë iu nënshtrua reformimit sipas parashikimit kushtetues për organet e drejtësisë ndryshuar me ligjin nr. 76/2016<sup>3</sup>, datë 22.07.2016 . Një reformim i tillë erdhi si një masë shumë e ashpër për të ndikuar në uljen e korrupsionit, keqfunksionimit, mungesës së integritetit dhe profesionalizmit, pavarësisë, efikasitetit, besueshmërisë, transparencës, llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë së sistemit<sup>4</sup>. Shtatë ligjet e Reformës në Drejtësi parashikojnë konkretisht: rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, organizimin dhe funksionimin e prokurorisë, organizimin e pushtetit gjyqësor, organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, si dhe organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese. Si rezultat i këtyre ndryshimeve ligjore, u krijuan Këshilli i Lartë i Gjykatave dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, të cilat gjithashtu janë subjekt monitorimi në këtë raport. Sikurse Reforma në Drejtësi parashikon të bëjë ndërhyrjet e nevojshme për të ulur kostot dhe për të

rritur efikasitetin, në vitin 2023, nga data 1 shkurt, do të mbetet vetëm një Gjykatë Apeli e vendosur në Tiranë dhe pesë gjykatat e tjera do të shkrihen duke iu bashkangjitur Gjykatës së Apelit Tiranë, e konsideruar si gjykata mëmë. Ky proces synon të ulë mbingarkesën e kësaj gjykate për çështjet e apeluara, në pritje për shqyrtim. Ende nuk ka një sqarim sesi do të operohet me ofrimin e shërbimit administrativ për qytetarët e rrethëve të Durrësit, Gjirokastrës, Korçës, Shkodrës dhe Vlorës, ku këto gjykata janë të vendosura tashmë.

### 2.1

#### HAPJA INSTITUCIONALE E GJYKATAVE NË REPUBLIKËN E

Gjykatat e Republikës së Shqipërisë kanë rezultuar 51.86% të hapura institucionalisht, në matjet e bëra për performancën e aktivitetit të vitit 2021. Krahasimisht me matjet e fundit të bëra në vitin 2018<sup>5</sup>, hapja institucionale e gjykatave të Republikës së Shqipërisë ka ndryshuar me 1.63 pikë përqindjeje. Më konkretisht, gjykatat kanë performuar 33.64% transparencë, 61.49% aksesueshmëri, 30.26% integritet, 29.93% efektshmëri dhe ndërgjegjësim; ku, Gjykata e Lartë ka performuar 51.52% transparencë, 75.65% aksesueshmëri, 41.67% integritet, 37.64% efektshmëri. Ndërsa Këshilli i Lartë i Gjykatave ka performuar 24.82% transparencë, 71.67% aksesueshmëri, 70% integritet dhe 63.33% efektshmëri. Për efekt krahasimi, në matjet e performancës së vitit 2018, gjykatat kanë shënuar 42.35% transparencë, 51.8% aksesueshmëri, 53.16% integritet dhe 76.49% efektshmëri. Të vetmit komponentë që janë përmirësuar janë transparenca dhe aksesueshmëria, ndërkohë që integriteti dhe efektshmëria janë në ulje të ndjeshme. Ky studim ka monitoruar 22 gjykata të rrethit, 6 gjykata administrative, 6 gjykata apeli, Gjykatën e Administrative

të Apelit, Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykatën e Lartën dhe Këshillin e Lartë Gjyqësor. Performanca e renditur për matjet e aktivitetit të vitit 2021, si në vijim:

1. Gjykata e Lartë 68.77%
2. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar 54.99%
3. Këshilli i Lartë Gjyqësor 52.37%
4. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar 42.64%
5. Gjykata e Administrative e Apelit 29.31%

#### Gjykatat e Rrethit:

1. Gjykata e Rrethit Gjirokastër 69.21%
2. Gjykata e Rrethit Vlorë 64.62%
3. Gjykata e Rrethit Krujë 63.77%
4. Gjykata e Rrethit Pukë 63.67%
5. Gjykata e Rrethit Berat 61.86%
6. Gjykata e Rrethit Përmet 61.24%
7. Gjykata e Rrethit Shkodër 60.1%
8. Gjykata e Rrethit Fier 59.44%
9. Gjykata e Rrethit Korçë 56.82%
10. Gjykata e Rrethit Kurbin 56.8%
11. Gjykata e Rrethit Lushnje 54.92%
12. Gjykata e Rrethit Lezhë 54.39%
13. Gjykata e Rrethit Mat 53.38%
14. Gjykata e Rrethit Elbasan 53.18%
15. Gjykata e Rrethit Durrës 52.92%
16. Gjykata e Rrethit Kavajë 52.37%
17. Gjykata e Rrethit Kukës 51.71%
18. Gjykata e Rrethit Sarandë 48.34%

.....

<sup>3</sup> Ligji nr. 76/2016, link: <https://bit.ly/3v8Fgev>

<sup>4</sup> Reforma në drejtësi: <http://www.reformanedrejtesi.al/pse-nje-reforme-ne-drejtesi> <sup>5</sup> EU projects in Albania, link: <https://bit.ly/3Wf6vzW>

<sup>5</sup> Hapja institucionale e gjyqësorit, viti 2019, link: <https://bit.ly/3YFOSN2>

19. Gjykata e Rrethit Tiranë 44.33%
20. Gjykata e Rrethit Pogradec 44.1%
21. Gjykata e Rrethit Tropojë 32.85%
22. Gjykata e Rrethit Dibër 23.35%

#### Gjykatat e Shkallës së Parë:

1. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë 63.6%
2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër 59.43%
3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës 54.4%
4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër 45.65%
5. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë 40.81%
6. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë 35.77%

#### Gjykatat e Apelit:

1. Gjykata e Apelit Shkodër 60.97%
2. Gjykata e Apelit Korçë 57.94%
3. Gjykata e Apelit Vlorë 54.87%
4. Gjykata e Apelit Durrës 43.65%
5. Gjykata e Apelit Gjirokastër 39.74%
6. Gjykata e Apelit Tiranë 34.83%

Vlen të theksohet se pas ndarjes së rezultateve të performancës me institucionet e këtij pushteti, Gjykata e Apelit Tiranë reagoi për të përmirësuar situatën aktuale. Pas asistencës së ofruar për rritjen e proaktivitetit të publikimit të informacionit zyrtar, Gjykata e Apelit Tiranë përqindja e hapjes institucionale ndryshoi nga 34.83% në 74.25%; më shumë se dyfish e treguesve të plotësuar. Gjykata e Apelit Tiranë renditet tek institucionet me performancën më të

## AKSESUESHMËRIA

lartë të hapjes institucionale në Republikën e Shqipërisë. Treguesit që u ndryshuan pozitivisht janë konkretisht: informacioni për personelin e gjykatës, planet vjetore të punës, raportet vjetore, strategjitë aktuale, lista e pagave të personelit, zyra e shtypit, trajnimet për të drejtën e informimit, aksesimi i ambienteve nga persona me aftësi të kufizuara, anonimat i seancave për të miturit, bashkëpunimi me median, kodi i sjelljes, kthimi i përgjigjes kundrejt kërkesës për informacion, statistikat vjetore. Pas përmirësimit të hapjes institucionale të kësaj gjykatë, rezultatet e performancës së komponentëve kanë ndryshuar lehtësisht. Më konkretisht, gjykatat kanë përformuar 34.48% transparencë, 62.4% aksesueshmëri, 30.92% integritet, 30.92% efektshmëri dhe ndërgjegjësimit.

## TRANSPARENCA

Të gjitha informacionet për gjykatat në Republikën e Shqipërisë janë të qendëruara në një faqe të vetme: atë të Këshillit të Lartë Gjyqësor<sup>6</sup>. Gjykata e Lartë ka në disponibilitet faqe më vetë, të administruar prej vetë institucionit<sup>7</sup>.

Për komponentin e transparencës, treguesit më të shpeshtë që shënojnë negativisht në performancën e gjykatave në Republikën e Shqipërisë kanë të bëjnë me informacionin për personelin, ku mungojnë jetëshkrimet e drejtuesve të institucionet, emrat e personelit gjyqësor dhe kategoritë përkatëse të pagës. Edhe pse gjykatësit janë subjekt deklarimi dhe pagat e tyre nuk përbëjnë informacion konfidencial, ende gjykatat nuk janë të hapura për të publikuar një informacion të tillë. Në thuajse shumicën e gjykatave, pavarësisht dokumentave për raportet vjetore të punës, planet vjetore mungojnë.

Disa prej treguesve që nuk janë plotësuar nga gjykatat, për sa i takon komponentit të aksesueshmërisë lidhen me publikimin e informacionit adekuat për grupet e marginalizuara, si dhe mungesa e informacionit të plotë sesi qytetarët mund të drejtojnë një ankesë në administratën e institucionit.

Opinionet e anëtarëve të këshillit nuk janë të publikuara në një seksion më vete dhe shumë prej gjykata nuk ofrojnë informacion mbi aksesueshmërinë e ambienteve të tyre për personat me aftësi të kufizuara.

## INTEGRITETI

Planet e integritetit shënojnë negativisht edhe në rastin e gjykatave. Pavarësisht kuadrit ligjor në fuqi dhe Kodit të Sjelljes, i cili gjendet i publikuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, planet dhe raportimet e sjelljes mbeten të munguara në akses elektronik. Gjithashtu, pjesëmarrja në trajnime për mbrojtjen e sinjalizuesve apo praktikave anti-korrupsion, paraqitet në nivele të ulëta.

## EFEKTSHMËRIA

Për komponentin e efektshmërisë, treguesit me frekuencën më të shpeshtë që kanë shënuar negativisht kanë të bëjnë me publikimin e statistikave të rasteve të shqyrtuara dhe përfshirjes në raportin vjetor të masave disiplinore të marra gjatë vitit nga gjyqtarët. Në një shënim pozitiv, të gjitha gjykatat që kanë kthyer përgjigje ndaj pyetësorit të dërguar, kanë pohuar dërgimin e raportit vjetor tek organet kompetente brenda afateve të përcaktuara ligjore.

<sup>6</sup> Gjykatat e Republikës së Shqipërisë, link: <https://gjykata.gov.al/>

<sup>7</sup> Gjykata e Lartë, link: [https://www.gjykataelarte.gov.al/web/Gjykata\\_e\\_Larte\\_1\\_1.php](https://www.gjykataelarte.gov.al/web/Gjykata_e_Larte_1_1.php)



Prokuroritë e Republikës së Shqipërisë kanë rezultuar 50.3% të hapura. Më konkretisht, komponentët e matjes së hapjes institucionale kanë performuar 30.2% transparencë, 79.05% aksesueshmëri, 30% integritet dhe 45% efektshmëri e ndërgjegjësimit. Prokuroritë shënojnë institucionit për rritjen më të ndjeshme të hapjes institucionale krahasimisht me performancën e aktivitetit të vitit 2018, ku hapja e tyre institucionale ka qenë 13.75%; 2.42% transparente, 12.91% të aksesueshme, 34.21% integriteti dhe 36.58% efektshmëri. Treguesi kryesor që ka ndikuar në këtë përmirësim situatë ka qenë krijimi i faqeve zyrtare të prokurorive, të cilat kanë qenë të munguara gjatë matjeve të para të kësaj metodologjie.

Ky studim ka monitoruar 22 prokuroritë pranë gjykatave të rretheve, 6 prokuroritë e apelit, Prokurorinë e Përgjithshme dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Performanca e renditur për matjet e aktivitetit të vitit 2021, si në vijim:

1. Prokuroria e Përgjithshme 64.54%
2. Këshilli i Lartë i Prokurorive 56.56%

Prokuroritë e Rretheve:

1. Prokuroria e Rrethit Elbasan 65.47%
2. Prokuroria e Rrethit Dibër 58.96%
3. Prokuroria e Rrethit Shkodër 56.89%
4. Prokuroria e Rrethit Mat 56.51%
5. Prokuroria e Rrethit Durrës 55.92%
6. Prokuroria e Rrethit Tropojë 54.52%
7. Prokuroria e Rrethit Kukës 53.74%
8. Prokuroria e Rrethit Lezhë 52.37%
9. Prokuroria e Rrethit Lushnje 52.37%
10. Prokuroria e Rrethit Vlorë 52.37%

11. Prokuroria e Rrethit Kurbin 52.37%
12. Prokuroria e Rrethit Tiranë 52.37%
13. Prokuroria e Rrethit Pogradec 49.41%
14. Prokuroria e Rrethit Përmet 46.45%
15. Prokuroria e Rrethit Krujë 41.21%
16. Prokuroria e Rrethit Berat 37.57%
17. Prokuroria e Rrethit Pukë 37.57%
18. Prokuroria e Rrethit Sarandë 37.57%
19. Prokuroria e Rrethit Kavajë 37.57%
20. Prokuroria e Rrethit Korçë 34.7%
21. Prokuroria e Rrethit Gjirokastrë 34.62%
22. Prokuroria e Rrethit Fier 34.62%

Prokuroritë e Apelit:

1. Prokuroria e Apelit Durrës 64.84%
2. Prokuroria e Apelit Shkodër 62.39%
3. Prokuroria e Apelit Vlorë 55.88%
4. Prokuroria e Apelit Gjirokastrë 49.96%
5. Prokuroria e Apelit Korçë 49.96%
6. Prokuroria e Apelit Tiranë 49.96%

## TRANSPARENCA

Faqet e prokurorive, njëjtë si në rastin e gjykatave, janë të qendëruara në faqen e Prokurorisë së Përgjithshme. Pavarësisht rritjes së performancës përmes krijimit të faqeve zyrtare online për këto institucione, vihet re se qëndrueshmëria dhe publikimi i vazhdueshëm i informacionit nuk janë ende në nivelet e duhura. Jetëshkrimet e drejtuesve dhe informacionet për personelin janë të munguara. Ndërkohë, që treguesit e tjerë shënojnë vlera pozitive për shkak se një pjesë e informacionit publikohet nga Prokuroria e Përgjithshme dhe gjendet në faqen e qendëruar.

## INTEGRITETI


Njëjtë si në performancën e gjykatave, edhe prokuroritë shfaqin mungesa në publikimin e raporteve vjetore të integritit dhe pjesëmarrjes në trajnime të fushës së anti-korrupsionit dhe mbrojtjes së sinjalizuesve.

## AKSESUESHMËRIA

Për këtë komponent, treguesit që ende nuk japin informacion për publikun lidhen me bashkëpunimin me median. Ndryshe nga gjykatat, nuk ka një detyrim ligjor për këto institucione që të kenë një Prokuror për Median. Pjesëmarrja një trajnime për rritje të kapaciteteve në fushën e të drejtës së informimit, mbrojtjes së të dhënave dhe publikimit të të dhënave të hapura mbetet në nivele të ulëta.

## EFEKTSHMËRIA

Treguesit e performancës për aktivitetin e prokurorisë dhe masa disiplinore të marra nga prokurorët gjatë vitit, nuk janë të reflektuara në raportet vjetore, në rastet kur ato gjenden të publikuara në faqet e prokurorive.



3

# METODOLOGJIA E KËRKIMIT

Qeverisja e hapur përfaqëson një kusht kyç të demokracisë pasi kjo u lejon qytetarëve të marrin informacion dhe njohuri të nevojshme për pjesëmarrje të barabartë në jetën politike, vendimmarrje efektive dhe pasjen e institucioneve të përgjegjshme për politikën të cilat ato ndjekin. Ndërkombëtarisht, institucionet ndërmarrin aktivitete të ndryshme me qëllim rritjen e transparencës së tyre dhe llogaridhënien e qytetarët. Indeksi Kombëtar i Hapjes Institucionale të pushtetit gjyqësor është ndërtuar në qëllim të përcaktimit se në cilën shkallë qytetarët marrin dhe kuptojnë informacionin e institucioneve të tyre. Indeksi Kombëtar i Hapjes Institucionale mat shkallën në të cilën institucionet publike janë të hapura për qytetarët dhe shoqërinë, duke u bazuar në

katër parimet bazë, të cilat janë:

- 1) Transparenca
- 2) Aksesueshmëria
- 3) Integriteti
- 4) Efektshmëria

Parimi i transparencës përfshin informacionin organizativ, buxhetin dhe procedurat e prokurimeve publike, të cilat janë në dispozicion të publikut dhe të publikuara. Aksesueshmëria është e lidhur me sigurimin dhe respektimin e procedurave për akses të lirë në informacion, duke përmirësuar disponueshmërinë e informacionit përmes mekanizmave të debatit publik dhe forcimin e ndërveprimit me qytetarët. Integriteti përbëhet nga mekanizmi i parandalimit të korrupsionit, mbajtjen e kodit etik dhe rregulloret e lobimit. Parimi i fundit, Efektshmëria i referohet monitorimit dhe vlerësimit të politikave të zbatuara nga

institucionet.

Duke ndjekur standardet ndërkombëtare, rekomandimet, si dhe shembujt e praktikave të mira, këto parime janë zhvilluar më tej përmes treguesve specifikë cilësorë dhe sasiorë, të cilët janë vlerësuar në bazat e: aksesueshmërisë së informacionit në website-t zyrtare të institucioneve, shqyrtimin e kuadrit ligjor për çështje të


veçanta, burimeve të tjera të informacionit publik dhe pyetësorëve të dorëzuar në institucione.

Përmes rreth 2'913 treguesve, kemi matur dhe analizuar hapjen institucionale të 39 gjykatave dhe 30 prokurorive në Republikën e Shqipërisë. Matjet janë kryer gjatë periudhës Mars – Gusht 2022.

# REKOMANDIME PËR HAPA KONKRETË VEPRIMI

4



Referuar në standardet ndërkombëtare të mirëqeverisjes dhe hapjes institucionale, ajo që vihet re më së shumti në performancën e sistemit gjyqësor në Shqipërisë është mungesa e vullnetit administrativ për të ofruar publikisht informacionin zyrtar. Me qëllim ndryshimin e kësaj situatë, lind nevoja e trajnimeve të vazhdueshme për të ndryshuar qëndrimin e gjyqtarëve/prokurorëve dhe personeleve administrative në dhënien e informacionit të konsideruar me interes publik; të ulen barrierat e




mendësisë së informacionit konfidencial duke konsideruar se veprimtaritë e këtyre institucioneve financohen nga fonde publike, ndaj qytetarët duhet të aksesojnë transparencë për përdorimin e këtyre fondeve.

Të investohet më shumë në zhvillimin e platformave të faqeve zyrtare. Pavarësisht detyrimin ligjor të sistemit gjyqësor për të rregjistruar seancat, faqet aktuale nuk mundësojnë publikimin e tyre, për shkak të madhësisë që këto dokumenta kanë.






**MJAFT!**  
[www.mjaft.org](http://www.mjaft.org)



Norwegian Embassy



[www.actionalbania.org](http://www.actionalbania.org)